



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Mbledhja nr. 107

Prishtinë, më 24.9.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Yllëza Hoti, Halil Thaçi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku dhe Albana Bytyqi.

Munguan: Visar Korencia, Rashit Qalaj, Hajdar Beqa. Bekim Arifi, dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit e tjerë: Fjollë Haziri KDI, Driada Thaçi, ZKA. Bekim Gashi, Shkurte Sadiku dhe Artizana Krasniqi, GP-LVV, Gent Ramosaj, GP-AAK.

Mbledhjen e kryesoi: Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2023;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023;
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2023;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për sesionin vjeshtor 2024;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Si komision kemi vendosur t'i shqyrtojmë disa Raporte të auditimit të Agjencive të pavarura që i raportojnë Kuvendit. Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit, ka opinion të pamodifikuar. Ky raport ka vetëm një gjetje që ka të bëjë me menaxhimin e pasurive kapitale dhe jokapitale. Pasuritë e dhuruara nga Komuna e Prishtinës ende figurojnë në regjistrat e pasurisë jofinanciare të IAP-së.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të IAP-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për IAP. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare, të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Ky raport po ashtu, ka opinion të pamodifikuar. Por ky raport ka rezultuar me 3 gjetje. Por, që këto gjetje nuk kanë materialitet për të pasur ndikim në opinion. Gjetjet kanë të bëjnë me: Zotimin e mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblertjes pas pranimit të faturës. Vonesë në pagesën e faturave. Mosregjistrimi i pasurive dhe paraqitje jo të plotë në shpalosjet e Pasqyrave Vjetore Financiare.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të APK-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për APK-në. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2023

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Edhe Raporti i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ka opinion të pamodifikuar. Ky raport ka rezultuar me një gjetje dhe ka të bëjë me: Funkcionimin e pozitës udhëheqës ekzekutiv me ushtrues detyre, për më shumë se 12 muaj siç e

parasheh Ligji nr 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, Neni 32. Ku pozita e Udhëheqësit Ekzekutiv funksionon me ushtrues detyre/zëvendësues që nga 13 shtator i vitit 2021.

Nëse nuk keni diçka për të shtuar atëherë po vendosim për raportin.

Përfundim

KMFP-ja vendosi që raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të KKTK-së, për vitin 2023, të mos e adresojë për shqyrtim në seancë plenare dhe nuk ka as rekomandime për KKTK-në. Për këtë njoftohet komisioni përkatës parlamentar.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për sesionin vjeshtor 2024

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Stafi i komisionit ka përgatitur dhe ka proceduar në komision për shqyrtim dhe miratim draft planin e punës së komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2024, siç kërkohet me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që komisionet çdo sesion të përgatisin planin e vet të punës.

Ky plan i punës së komisionit është përgatitur bazuar në fushëveprimin e komisionit. Plani mund të plotësohet dhe ndryshohet varësisht nga dinamika e punëve të komisionit dhe vendimet e Kryesisë së Kuvendit. Por, siç po shihet, tani kemi mungesë kuorumi, ndaj nuk kemi vota as për të votuar për Planin e punës e as për pikat që i kemi në të ndryshme. Andaj këtu e mbyllim takimin për sot.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit